



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 66

Prishtinë, më 20 nëntor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Berat Buzhala, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

I pranishëm në mbledhje ishte ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj, me ftesë të Komisionit dhe stafi nga MPJ: Ylber Kryeziu, Sylë Ukshini, Pëllumb Kallaba, Albert Prenkaj, Gëzim Visoka, Muhamet Brajshori dhe Artan Behrami.

Pjesëmarrës të tjerë: Vlora Nushi- UNMIK/OPA, Lumnije Murati-ZPRK, Arsim Krasniqi nga kolegji “Fama”, Puhije Demaku- LVV, Naim Jakaj- GP-VV dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka- praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj.

1. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj

Albin Kurti, fillimisht kërkoi nga Ministri Hoxhaj që të paraqesë një ekspozë lidhur me temat që janë në interes të Komisionit.

Enver Hoxhaj shprehu kënaqësinë për të raportuar në Komisionin për Punë të Jashtme dhe theksoi se ky raportim do të fokusohet kryesisht në aktivitetet e tre muajve të fundit, gjegjësisht kohës nga raportimi i fundit i tij në Komision e deri më tani dhe se do të mund të bisedohet edhe për aktivitetet e MPJ-së gjatë vitit të ardhshëm.

Fillimisht theksoi se ky vit ka qenë i suksesshëm sa i përket aspektit bilateral të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti Kosovën e kanë njohur tetë vende, ndërsa nga raportimi i tij i fundit tha se Kosovën e kanë njohur katër vende: Tailandë, El Salvadori, Libia dhe Grënada. Ai, po ashtu, njoftoi për angazhimin dhe numrin e madh të vizitave që ka bërë në vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, në vende me peshë, si dhe në pesë vendet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Republika e Kosovës ka 63 marrëveshje të nënshkruara diplomatike me vende të ndryshme të botës, ku ndër të fundit hynë Panamaja dhe Kosta Rika. Informoi se deri më tani Kosova ka të lidhura 152 marrëveshje ndërkombëtare, nga të cilat 140 janë bilaterale, ndërsa 10 prej tyre janë multilaterale dhe se kanë në prioritet nënshkrimin e 100 marrëveshjeve ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të raporteve në të gjitha fushat e jetës në mes të Republikës së Kosovës dhe vendeve të tjera. Prioritet i rëndësishëm i MPJ-së gjatë këtij viti tha se ka qenë aspekti multilateral i politikës së jashtme, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Ministri Hoxhaj theksoi anëtarësimin e Kosovës në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, dhe në Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim dhe beneficionet e Kosovës me rastin e anëtarësimit në këtë bankë. Shprehu interesimin që në koordinim me KPJ, KIE, Qeverinë e Presidencën, në vitin e ardhshëm do të fillojë procesi për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Njoftoi se gjatë këtij viti është hartuar një dokument strategjik se si t'i qasemi OKB-së dhe njoftoi në hollësi për angazhimin e MPJ-së në këtë drejtim. Sa i përket integriteteve euroatlantike ky vit tha se ka qenë shumë i rëndësishëm për politikën e jashtme të Kosovës, meqë u hapën negociatat për nënshkrimin e MSA-së. Sa i përket bashkëpunimit rajonal, tha se Kosova ka pasur bashkëpunim të shkëlqyer rajonal, me përjashtim të Serbisë, me të cilën jemi në proces të normalizimit të relacioneve. Prioritet të MPJ-së, po ashtu ceku anëtarësimin e Kosovës në nisma dhe forume rajonale dhe si ngjarje të rëndësishme në këtë bashkëpunim theksoi anëtarësimin e Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal. Lidhur me shërbimin e jashtëm, ministri njoftoi se ambasadori Sabri Kiqmari ka lëvizur nga Vjena në Australi dhe se gjenden në procedurë të hapjes së ambasadave në Panama e Egjipt, të cilat duhet të kenë rol kontinental. Njoftoi edhe për hapjen e konsullatave në Gjenevë, Strasburg, dhe në Stamboll. Ministri njoftoi anëtarët e Komisionit edhe për numrin e stafit në MPJ, kornizën ligjore të ministrisë, për planet për hartimin e platformës afatgjate të politikës së jashtme, si dhe për buxhetin e MPJ-së.

Albin Kurti duke u ndërlidhur me materialin të cilin Ministri ju kishte përcjellë anëtarëve të Komisionit, më 24 korrik 2013, kërkoi që t'u përcillet edhe pasqyra financiare mbi të hyrat dhe shpenzimet, ku tregohen shpenzimet e hollësishme sa i përket linjave buxhetore, mallra dhe shpenzime, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzimet kapitale për vitin 2012 dhe 2013, shpenzimet për kodin 011200, pagesa për punë jashtë orarit, shtesat dhe stimulimet, si dhe Planin e veprimt për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Në vazhdim kryetari i parashtrroi këto pyetje: Cilët janë kategoritë e deputetëve në Asamblenë Parlamentare të KE- së që ju mendoni që do të votonin kundër anëtarësimit të Kosovës? Çfarë masash keni marrë dhe do të merrni ju për t'i bindur ata që të ndryshojnë qëndrimin ndaj anëtarësimit të Kosovës? Cilat janë veprimet lobuese që janë ndërmarrë deri më tani për të bindur anëtarët e Asamblesë Parlamentare që të votojnë pro anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës? Çfarë janë pengesat që mbesin në këtë drejtim? Nëse anëtarësimi në RCC ka qenë i garantuar nga ana e Bashkimit Evropian pas Marrëveshjes për pjesëmarrje në forumet rajonale, marrëveshja e fusnotës, si është njohur ndryshe, pse atëherë keni pranuar që RCC të bëjë ndryshime në statutin e saj, duke e akomoduar Kosovën vetëm pasi që u hoq fjala anëtarësim dhe u zëvendësua me fjalën pjesëmarrje në statut? A keni kërkuar përgjegjësi për këtë nga ana e garantuesit të marrëveshjes në fjalë? Nëse jo, a keni parasysh që ky ndryshim statutar e ka zbehur anëtarësimin e Kosovës në RCC, sepse është zëvendësuar fjala anëtarësim me pjesëmarrje? Si është e mundur që Marrëveshja për Pjesëmarrje në Forumet Rajonale në mes të

Kosovës dhe Serbisë, edhe pse e nënshkruar nën garancinë e BE-së, sërish nuk po e bën të mundur anëtarësimin e Kosovës në organizatat derivative të RCC-së, si Business Advisory Council, Energy Community Secretariat, SEE Trade Union Forum, Secretariat of the SEE Policy Cooperation Convention, e të tjera? A do të thotë kjo që marrëveshja në fjalë nuk po gjen zbatim dhe Kosova sërish nuk po arrin të marrë pjesë në forumet rajonale, garancia për anëtarësimin në të cilat është dhënë nga BE, nën kushtin që Kosova ta pranonte këtë marrëveshje për pjesëmarrje në forumet rajonale? Çfarë qëndrimi zyrtar keni ndaj marrëveshjes në fjalë, nëse ajo po shkelet nga Serbia në mënyrë të hapur? Sa është numri i zyrtarëve civilë diplomatikë të pranuar në shërbimin e jashtëm të Kosovës në dy vitet e fundit, si numër? Mbi çfarë kritere janë pranuar ata? Kryetari i Komisionit kërkoi që anëtarëve të Komisionit t'u silllet lista me emra, pozitë dhe gradë diplomatike në të cilët ata gjenden për momentin, dhe rekordin e tyre të dy viteve të fundit, ngase tha se kemi marrë vetëm ekstrakte të procesverbaleve, si dhe vendimet për pranim, vlerësim, dhe krahasim në mes të kandidatëve konkurrentë dhe atyre të pranuar për tërë rekrutimet e bëra në stafin diplomatik civil në dy vitet e fundit. Më tej shtroi edhe këto pyetje: A e keni ndjekur me përgjegjësi zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në rastet e propozimeve të dhëna për emërimin e ambasadorëve të Republikës së Kosovës? A është kryer studimi i cili shpjegon qëllimet, rrugët, metodat dhe strategjinë sa i takon anëtarësimin të Kosovës në OKB? Pse nuk po përditësohet ueb faqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme, aty ende figurojnë vetëm 96 shtete që e kanë njohur Kosovën? A ka përfunduar procedura e verifikimit për njohjet nga Uganda dhe Nigeria ? Pse këto dy shtete gjenden ende në listën e vendeve që e kanë njohur Kosovën? Sa i përket Akademisë Diplomatike, buxheti për vitin 2014 është më i lartë, por, a do të mjaftojë ky buxhet për arritjen e qëllimeve të Akademisë? Cila është struktura e brendshme e rritjes së pagave dhe mëditje të shtuara, pasi numri i të punësuarve s'po rritet? A është e vërtetë se në shumicën e departamenteve politike janë zyrtarë me kontratë, akt-emërim dhe, në të njëjtën kohë, janë edhe me pozita ushtrues drejtor të departamenteve? A është e vërtetë se zotëri Blerim Vela ka qenë për një javë shef i kabinetit tuaj me vendim dhe pas një jave e ka lëshuar punën? Cila është arsyeja? A mendoni se Pëllumb Kallaba, që tani është shef kabineti, e në të njëjtën kohë e ka edhe prindin e tij ambasador në Bullgari, është çështje e drejtë? A është e vërtetë se shumica e stafit tuaj kanë nga dy pozita të njëjta në të njëjtin departament, duke mos pasur harmonizim me procedurat që duhen ndjekur? A është e vërtetë që shumica e stafit diplomatik, konsullor janë ankuar dhe kanë kërkuar nga Ju që t'i sistemoni sipas procedurave ligjore, por ju nuk e keni përfillur këtë si ministri, institucion? A është e vërtetë që po keqpërdoret buxheti me procedurat e postës DHL nga misionet tona diplomatike duke i shfrytëzuar ato për interesa personale? Cila është gjendja në Ambasadën e Kosovës në Tiranë ku mungon tash e shumë kohë ambasadori? A keni marrë një letër nga Gjergj Viçishta për shkeljet e ambasadorit Kallaba? A do t'i merrni parasysh dëshmitë e dhëna nga shoferi Viçishta? A keni ndërmarrë ndonjë hap rreth këtij rasti? A ka filluar Komisioni disiplinor të shqyrtojë rastin e Shpend Kallabës? A janë shqyrtuar shkaqet e aksidentit që kanë ndodhur në Maqedoni më 3 maj të vitit 2013? A ka qenë ambasadori në detyrë në momentin kur ka ndodhur aksidenti? Çfarë ka ndodhur me rastet Hamiti e Musliu, ku ka arritur Komisioni hetues dhe a janë shqiptuar masat për këto raste? A jeni në dijeni se disa ambasadorë dhe anëtarë të stafit diplomatik kanë marrë pjesë në fushatë? Sa është numri i refugjatëve nga Kosova në Francë të cilët, siç është raportuar edhe nga mediat vendore e edhe ndërkombëtare, jetojnë nën ura, e madje edhe në rrugë kohëve të fundit? Çfarë informata keni mbi mirëqenien e tyre dhe cilat masa i keni ndërmarrë? A ka mbaruar demarkacioni me Malin e Zi, nëse jo, përse dhe deri ku është arritur? Çfarë hapash keni ndërmarrë deri më tani për zbatimin e Marrëveshjes për konsullatat e përbashkëta me Shqipërinë dhe ku ka stagnuar procesi?

Hydajet Hyseni shprehu konsideratën për punën që është bërë në Ministri dhe për sukseset e shënuara, në ndërkohë, në këtë fushë të rëndësishme për Kosovën. Duke e pasur parasysh se ky raportim i ministrit, është për punë të jashtme në Komisionin për Punë të Jashtme, tha se do të fokusohet kryesisht në çështje të kësaj natyre. Në këtë drejtim kërkoi të informohet nga ministri se, cilat janë planet në të ardhmen për konsolidimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Lidhur me agjendën për integritet evropian, tha se dokumenti i cili është sjellë nga Qeveria në Këshillin për Integritet Evropian, ka bërë përshtypje jo të mirë dhe se Kosova duhet të jetë më e përgatitur dhe më dinamike në këtë proces. Shtroi pyetjen se cili është vlerësimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme për dinamikën që i duhet Kosovës në këtë proces jetik? Duke u ndërlidhur me synimet e Kosovës për integritet në institucione ndërkombëtare dhe me diskutimet se Rezoluta 1244 është e vdekur, theksoi se si mund të kuptohet kjo në raport me fusnotën, e cila për fat të keq nuk është e vdekur. Po ashtu z. Hyseni tha se ka vend për të folur pak më shumë për rolin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në procesin e komunikimit ndërkombëtar, në këtë rast për dialogun Prishtinë-Beograd dhe për pozicionin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në gjithë këtë proces. Pyeti ministrin se a e konsiderojnë të mjaftueshëm planifikim buxhetor për Ministrinë e Jashtme për vitin 2014 dhe se a ka nevojë që të angazhohet Komisioni në këtë drejtim? Shtroi çështjen e vështirësive në realizimin e të drejtave në të cilat hasin mërgimtarët tanë në vendet ku jetojnë, si dhe të problemeve formale-juridike gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, për të cilën çështje kërkoi të informohet nëse ka ndonjë lëvizje të re.

Skender Hyseni gjatë diskutimit të tij tha se do të ndalet në dy tri çështje të cilat i konsideron thelbësore për politikën e jashtme të Kosovës. Fillimisht pyeti Ministrin Hoxhaj se MPJ, nën udhëheqjen e tij, a është duke e zbatuar në mënyrë konsensuale legjislacionin në fuqi për politikën e jashtme, në veçanti Ligjin për shërbimin diplomatik dhe konsullor. Duke u ndërlidhur me diskutimin e ministrit se pesë vende të BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën, nuk e përbëjnë një bllok, në kuptim të qëndrimeve politike të unifikuara, tha se këto pesë vende kanë arritur në mënyrë shumë të suksesshme ta imponojnë në Bruksel, politikën e neutralitetit ndaj statusit të Kosovës. Lidhur me këtë pyeti se çfarë po bën MPJ përpos konstatimit teknik të kësaj gjendje, ta ndryshojë politikën e neutralitetit ndaj statusit. Theksoi se më 18 gusht 2010, në cilësi të ministrit të MPJ-së në takim me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së ka shtruar për herë të parë kërkesën që Rezoluta 1244 duhet të zëvendësohet me një rezolutë të re. Mirëpo Qeveria aktuale në vend se të vazhdonte të insistonte në zëvendësimin e kësaj rezolute ka bërë gabim, që me pëlqimin e saj ka pranuar që Rezoluta 1244 të vendoset në fusnotë si referencë. Diskutimin se Rezoluta 1244 është e vdekur, z. Hyseni e konsideron atë të ringjallur, me vendosjen e saj në fusnotë. Rezoluta 1244 tha se nuk vdes, por ajo duhet të zëvendësohet me rezolutë të re. Z. Hyseni kërkoi të njoftohet nga ministri lidhur me shkeljet e ligjit në MPJ, me rastin e punësimeve dhe mosrespektimit të vendimeve të gjykatave, për të cilat tha se ka informacione.

Donika Kadaj - Bujupi të gjeturat në Raportin e Progresit, si dhe moszbatimin e ligjeve i konsideroi se janë probleme evidente në shoqërinë tonë. Lidhur me këto çështje e pyeti ministrin, se MPJ a ka hartuar një plan veprimi lidhur me përgjegjësitë nga Raporti i Progresit, cilët janë hapat e ndërmarrë, a kanë reflektuar dhe në cilën fazë gjenden.

Enver Hoxhaj duke u ndërlidhur me çështjet e parashtruara nga deputetet, theksoi se do të përcjellë listën e kërkuar për shpenzimet e MPJ-së për vitin 2012 dhe 2013, ndërsa sa i përket mëditjeve, si Ministër i Punëve të Jashtme deri me tani nuk ka marrë asnjëherë mëditje për asnjë vizite jashtë vendit. Sa i përket planit të veprimi për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës tha se i takon deputetëve se në çfarë forme do t'i qasemi kësaj procedure dhe se e kanë një memorandum, i

cili e shpjegon aspektin legal, procedural dhe qëllimin politik të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Sa i takon anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Kosovës në RCC, ndryshimit të statutit të kësaj organizate tha se ne kemi reaguar për mosanëtarësimin e Kosovës në derivatet e RCC-së, në 29 organizata për të cilat ka dërguar disa nota verbale në disa vende të ndryshme të botës dhe se vizitat e fundit të tij kanë pasur të bëjnë pikërisht me moszbatimin e marrëveshjes, të cilën Serbia po e shkel çdo ditë. Listën dhe numrin e rekruteve për këto dy, tri vitet e fundit, tha se do të ia përcjellë Komisionit. Sa i përket studimit për OKB-në tha se e kanë të gatshëm dhe në momentin që e lejon sponsori, i cili e ka sponsorizuar këtë studim, mund ta ndajnë me Komisionin. Ministri dha shpjegimet lidhur me njohjet nga Uganda dhe Nigeria, dhe bëri të ditur se në janar të vitit 2014 do ta kenë një listë përfundimtare ku do të trajtohet çështja e këtyre dy njohjeve. Lidhur me buxhetin e Akademisë Diplomatike, tha se ajo, këtë vit ka buxhet më të madh dhe se janë të interesuar që nga viti i ardhshëm të sjellin një drejtor ndërkombëtar, i cili do të duhej ta drejtonte Akademinë Diplomatike. Ministri bëri të ditur numrin e stafit në ministri dhe në misionet diplomatike. Njoftoi se z. Blerim Vela për një javë ka qenë shef i Kabinetit të tij dhe është larguar për shkaqe të natyrës profesionale të karrierës së tij. Sa i përket shefit të Kabinetit, Pëllumb Kallaba, ministri njoftoi se pozicioni i tij nuk ka të bëjë me pozitën që e ka ambasadori Kallaba, ndërsa sa i përket çështjes së ngritur për shkeljet nga ambasadori Kallaba, tha se me këtë çështje është marrë Komisioni për Disiplinë dhe Grada. Për aksidentin në Maqedoni, tha se lidhur me këtë çështje mund të japë edhe informata shtesë, por pa prezencën e mediave. Lidhur me rastin Hamiti dhe Musliu, tha se është marrë Komisioni për Grada dhe Disiplinë, vendimet e të cilit janë respektuar. Sa i përket azilkërkuesve në Francë njoftoi se ambasadori Muhamedin Kullashi ka bërë të ditur se numri i azilkërkuesve nuk kalon mbi 400, ndërsa në Hungari aktualisht janë rreth 281 azilkërkues. Demarkacioni me Malin e Zi tha se është kryer 80% dhe për këtë çështje kurdo që Komisioni është i gatshëm mund të informohet në detale për të gjitha dilemat. Ai bëri të ditur se prej ish-kufijve të brendshëm të Jugosllavisë vetëm dy kufijet janë demarkuar deri më tani, kufiri Kosovë-Maqedoni dhe kufiri që po demarkohet Kosovë-Mali i Zi. Sa i takon marrëveshjes për bashkëpunim konsullor Kosovë-Shqipëri është nisur ky proces me ministrin Haxhinasto dhe se do të definohet për vitin 2014 se ku do të mund të bashkëpunonin në këtë drejtim. Lidhur me pyetjen e deputetit Hydajet Hyseni për pritjet për vitin 2014, tha se gjatë vitit 2014 jeni të interesuar ta përmbyllim platformën e politikës së jashtme, e cila njëkohësisht duhet të jetë edhe instrument i harmonizimit të politikës së jashtme të Kosovës në rrafshin e MSA-së dhe do të kemi një person, i cili do të jetë në procesin e negocimit me zyrën e Baroneshës Ashton. Lidhur me përafrimin e politikës së jashtme të Kosovës me BE-në, dialogun politik, bashkëpunimin rajonal dhe konventave të tjera tha se zëvendësministri do të bashkëpunojë me Drejtorin për Ballkan të Baroneshës Ashton. Sa i përket marrëdhënieve bilaterale dhe marrëveshjeve diplomatike tha se prioritet është anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës dhe anëtarësimi në dy agjenci të OKB-së gjatë vitit të ardhshëm. Po ashtu prioritetet të MPJ-së do të jenë zëvendësimi i Rezolutës 1244 dhe qasja ndaj OKB-së, njohjet, zgjerimi dhe fuqizimi i rrjetit konsullor. Ministri, po ashtu, theksoi se agjenda e integritimeve evropiane duhet të jetë prioritet dhe ndoshta NATO-ja mund të jetë hallka e parë në mes të anëtarësimit të Kosovës në NATO, BE dhe OKB. Ka përpjekje që UNMIK-u të mbahet gjallë, vetëm përmes raportimeve në Këshill të Sigurimit, ai duhet të përfundojë dhe të mos ekzistojë më as si zyre në Kosovë, por të shndërrohet në një zyrë të OKB-së. Ministri njoftoi për dialogun dhe për bashkëpunimin rajonal. Sa i përket stafit në ambasada, njoftoi se të gjithë janë pranuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i janë nënshtruar procesit të provimeve gjuhësore. Ministri njoftoi se ndaj 5 shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën është menduar për pikënisje të bashkëpunimit institucional në mënyrë që ato të lëvizin drejt njohjes. Është bërë përpjekje maksimale me institucionet e BE-së dhe me 5 vendet që nuk e kanë njohur Kosovën që politika e tyre e rezervuar karshi shtetit të Kosovës të shndërrohet në politikë aktive pozitive, me raste konkrete. Sa i përket rezolutës 1244 dhe

marrëveshjes për fusnotë, tha se këtë duhet ta lexojmë edhe në një rrafsh tjetër, sepse nuk do të kishte studim të fizibilitetit për Kosovën po që se Kosova nuk do ta kishte këtë formulë të përfaqësimit në rajon dhe Evropë. Lidhur me Raportin e progresit ministri Hoxhaj bëri të ditur se kanë një plan aksional për t'i adresuar sfidat e MPJ-së, por ky raport nuk përmban shumë sfida për MPJ-në. Ai njoftoi se gjenden në fazën e rishikimit të dy ligjeve për të cilat së bashku me Komisionin mund të organizohet një debat lidhur me to.

Sabri Hamiti bëri të ditur se, si kryetar i këtij Komisioni në legjislaturat e mëparshme dhe si Nënkryetar i Kuvendit, gjithnjë ka thënë dhe e përsëriti se Kosova është vend i vogël, pret të marrë imazh dhe të pranohet jashtë, prandaj duhet të ketë politikë të jashtme konsensuale dhe se mbi këtë bazë është përpjekur që të punojë në të gjitha nivelet në Kuvend. Për çështje të politikës së jashtme tha se kërkohet konsensus, prandaj duhet të bisedohet në mbledhje plenare, qoftë në formë interpelance ose në ndonjë formë tjetër të zgjerohet rrethi dhe të bisedohet në ç' drejtim po shkojnë këto politika.

Ministri Hoxhaj i njoftoi anëtarët e Komisionit edhe për disa çështje dhe shqetësime të ngritura në këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 12:40.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit